



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE

DEGA VENDORE DURRES

NR. 2250 REP. NR. 987/1 KOL.

DURRËS MË 03 06.2019

**KONTRATË SHITJE KUOTASH  
ME KUSHT**

Në Durrës, sot më 03.06.2019 (dymijë e nentëmbëdhjetë), ditën e Hënë në zyrën e noterisë, përpara meje noteres Rovena Jakova, anëtare e Dhomës Kombetare Të Noterëve, Dega Vendore Durrës, me seli në Lagja nr.4, rruga "Egnatia", u paraqitën personalisht shtetasit e përshkruar më poshtë:

**PALA SHITËSE:**

1. **COSTANTINO FORCHINI**, i biri i Pietro, i datelindjes 11.09.1963, lindur ne Teramo (TE) dhe banues ne Itali, Rr : Marrocchi nr. 11 64012 Sant' Onofrio di Campli (TE), nenshtetas italian, i identifikuar nga Pasaporta Personale e Republikës se Italisë nr. YA7595470 , leshuar me date 05.06.2015 dhe date skadimi 04.06.2025.

2. **CLAUDIO FORCHINI**, i biri i Pietro, i datelindjes 17.07.1965, lindur ne Teramo (TE) dhe banues ne Itali, Rr : Marrocchi nr. 11 64012 Sant' Onofrio di Campli (TE), nenshtetas italian, i identifikuar nga Pasaporta Personale e Republikës se Italisë nr. YA8768671 , leshuar me date 23.02.2016 dhe date skadimi 22.02.2026.

(më poshtë referuar si "Shitësi")

Dhe

**PALA BLERËSE**

**Shoqeria "Denim Inn" srl**, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , e regjistruar ne Dhomen e Tregtise, Industrise, Artizanatit dhe Bujqesise te Republikës se Italisë me date 03.08.2011, me kod fiskal dhe numer regjistrimi 02101260442 ne Regjistrin e Ndermarrjeve te Marche, me seli ne Spinetoli, (AP), Via Luciano Lama, 1 Cap 63078, perfaqesuar edhe me Vendim Asambleje te dates 03.05.2019 nga **Z. STEFANO PIZZINGRILLI**, i biri i Giuseppe-s, i datelindjes 30.07.1972, lindur ne Ascoli Piceno (AP) dhe banues ne Itali, Rr Mazzini 170 63100 Ascoli Piceno (AP), nenshtetas italian, i identifikuar nga Pasaporta Personale e

Republikes se Italisë nr. YB4323022, leshuar me datë 15.01.2019 dhe datë skadimi 14.01.2029.


(më poshtë referuar "Blerësi").

Madhorë e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët me dëshirë dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, më kërkuan redaktimin e kësaj kontrate shitblerje kuotash, në bazë të ligjit nr 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" si dhe Statutit të shoqërisë, në të cilën deklaruan:

- (A) Shitësit zotërojnë 2 (dy) kuota , 1 (nje) kuote secili , të cilat përbejnë 34 % (17% secila kuote) të kapitalit themeltar të shoqërisë DB WASH INTERNATIONAL sh.p.k, (më poshtë referuar si "Kuotat në Shitje") një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, themeluar dhe organizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër identifikimi të subjektit NIPT L41525504M, me seli qendrore në Durrës Xhafzotaj, Stacioni Zooteknik Xhafzotaj, objekt me nr.pasurie 163/8 ZK 2574 (më poshtë referuar si "Shoqëria" ose "DB Wash");
- (B) Shitësit janë pronarë të vetëm dhe të ligjshëm të Kuotave në Shitje dhe këto kuota janë shlyer plotësisht nëpërmjet kontributit në para në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- (C) Në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe ligjit shqiptar për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 datë 14.04.2008 me ndryshimet përkatëse, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë është vendosur transferimi me ane të shitblerjes i kuotes përkatëse në kapitalin themeltar të ortakëve Claudio Forchini dhe Costantino Forchini dhe ushtrimi i drejtës së parablerjes nga ortakët e tjerë.
- (D) Palët bien dakort për nënshkrimin e kësaj kontrate për shitjen e 2 (dy) kuotave të cilat në total përbejnë 34 % (17% secila kuote) të kapitalin themeltar nga Shitësit tek Blerësi/it ("Kontrata për shitjen e kuotave" ose "Kontrata") si më poshtë vijon:

#### Neni 1

#### Objekti i Kontratës



1.1 Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate (Data e nënshkrimit), Shitësit i shesin me këste Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësit, 2 Kuotat në Shitje të barabarta me 34 % të Kapitalit themeltar të Shoqërisë Db Wash International sh.p.k, dhe konkretisht si më poshtë:

- Shitësit z.Claudio Forchini dhe z.Costantino Forchini i shesin Blerësit shoqërisë "Denim Inn"srl kuotën e tyre takuese të cilat përbejnë 17 % të kapitalit themeltar secila pra në total 34 % të kapitalit themeltar të shoqërisë me cmimin e shitjes 1 000 000.00 ( një milion) Euro.


1.2 Kuotat në shitje do të transferohen nga pronësia e Shitësit në pronësi të Blerësit dhe pala Blerëse do të bëhet zotëruese ligjore e Kuotave në shitje, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pjesëmarrja e ortakëve në shoqëri do të bëhet si më poshtë:

- Xhulio Dako do të jetë ortak i shoqërisë duke zotëruar 1 (nje ) kuote e cila përben 20 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë
- Tomi Ismailati do të jetë ortak i shoqërisë duke zotëruar 1 (nje ) kuote e cila përben 9 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë
- Shoqëria "Denim Inn"srl do të jetë ortak e shoqërisë duke zotëruar 1 (nje ) kuote e cila përben 34 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë
- Vincenzo Di Ascenzo do të jetë ortak i shoqërisë duke zotëruar 1 (nje ) kuote e cila përben 13 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë
- Roberto Aquilanti do të jetë ortak i shoqërisë duke zotëruar 1 (nje ) kuote e cila përben 7 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë
- Stefano Pizzingrilli do të jetë ortak i shoqërisë duke zotëruar 1 (nje ) kuote e cila përben 17 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë

Pala Blerëse merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej nënshkrimit të kësaj kontrate dhe zotërimit të 34 % të kapitalit themeltar.

## Neni 2

### Çmimi i Shitjes dhe mënyra e likuidimit



- Çmimi total i shitjes se 2 (dy)kuotave te cilat ne total perbejne 34 % te kapitalit themeltar , i pagueshem nga Pala Blerëse për Shitësit është 1 000 000.00 ( nje milion) Euro , i cili ndahet në pjesë te barabarte për cdo Blerës, sipas nenit 1.1 më sipër.
- Palët në këtë kontratë janë dakort dhe deklarojnë se shuma e shitblerjes se kuotave, sipas çmimit të përcaktuar në nenin 3 më sipër, në vlerën totale 1 000 000.00 ( nje milion) Euro do të shlyhet me këste dhe në përputhje me pjesët takuese të çdo shitesi, të cilat do të paguhen me 8(tete) keste tremujore ne fund te muajit te trete, prej 125 000 (njëqind e njetete e pese mije) euro secili , nga te cilat kesti i pare eshte likujduar nepermjet transfertes bankare ne llogarine bankare te secilit ne menyre te barabarte dhe kesti i fundit do te likujdohet deri me date 28.02.2021.

1.3 Pagesat do të kryhen në llogaritë bankare perkatese te secilit prej Shitësve te cilet do të vërtetojnë shlyerjen e kështit përkatës me anë të mandateve bankare përkatëse.


### **Neni 3**

#### **Kushtet e Kontratës**

- 3.1 Palët e kësaj kontrate janë dakort dhe deklarojnë se me shlyerjen e kështit të fundit në shumën përkatëse, përfundon ne menyre definitive kjo kontrate shitblerje duke u plotësuar ne kete menyre kushti i kësaj kontrate, fakt i cili do te vërtetohet me mandatet bankare perkatese , te cilat do te dorëzohen ne QKB, ne rast se ndonje nga keestet nuk eshte shlyer sipas menyres dhe afateve te vendosura ne kete kontrate atehere shitesit kane te drejte te veprojne ligjerisht ndaj shoqerise (pales blerëse).
- 3.2 Palët në këtë kontratë janë dakort dhe deklarojnë se pavarësisht kohës së likujdimit të çmimit të kontratës, me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pala Blerëse (Bleresi), bëhet pronare dhe zotëruese me efekte të plota ligjore të pjesëve të kapitalit të ortakeve Claudio Forchini dhe Costantino Forchini, gjithashtu Shitësit me nënshkrimin e kësaj kontrate zhvishen nga zotërimi i 2 (dy)kuotave te cilat ne total perbejne 34 % te kapitalit themeltar .

### **Neni 4**

#### **Detyrimet Reciproke**




- 4.1 Shitësit garantojnë Blerësin për kalimin e pronësisë së kuotave të tyre takuese që zotërojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë Db Wash International shpk, në gjendje të lirë ndaj çdo lloji detyrimi ose barrë mbi këto kuota.
- 4.2 Blerësi është i detyruar dhe i garanton Shitësit, që në rast të transferimit të kuotave që i nënshtrohen shitjes aktuale, detyrimet dhe të drejtat e kësaj kontrate do të vazhdojnë të jenë në fuqi.
- 4.3 Shitësit nuk do të kërkojnë pjesë nga fitimi i mundshëm që do të krijohet Shoqëria në vijim gjatë aktivitetit tregtar. Ky rregull nuk është i vlefshëm në rastin kur kjo kontratë priset dhe/ose nuk zbatohet kushti sipas përcaktimeve në nenin 3.2 më sipër.
- 4.4 Blerësi në mënyrë të vecantë garanton Shitësit se do të shlyejë çmimin e kësaj kontrate sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
- 4.5 Blerësi në asnjë rast, nuk do të kërkojë shitësit pjesë nga shpenzimet apo humbjet e mundshme që do të krijojë shoqëria në vijim nga aktiviteti tregtar, ky rregull është i vlefshëm dhe në rastin kur kjo kontratë priset dhe/ose nuk zbatohet kushti sipas përcaktimeve në nenin 3.1 dhe 3.2 më sipër.

## **Neni 5**

### **Dispozita Perfundimtare**

- 5.1 Palët në këtë kontratë janë dakort dhe deklarojnë se kjo kontratë priset në rastet e mosplotësimit të kushteve të kësaj kontrate, në rastet e pasrshikuara në Kodin Civil, si dhe në çdo rast me vullnetin e tyre të lirë, me efekt kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 5.2 Kjo kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe veçanërisht dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit për "Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" me ndryshimet përkatëse.
- 5.3 Tatimi mbi të ardhurat për kalimin e kuotave nga Shitësi tek Blerësi do të derdhen në shtetin ku janë rezidentë shitësit, Itali, sipas nenit 13 n.3 të Konventës së datës 21.05.1998, nr.175, midis shtetit Italian dhe Shtetit Shqiptar, të cilat duhet të paguhet sipas ligjeve në fuqi. Shitësit deklarojnë që kalimi i kuotave janë subjekt i të ardhurave në Itali, sipas nenit 67 e vijues i direktives 22.12.1986 n.917 e s.i.m.
- 5.4 Për këtë qëllim shitësit deklarojnë:



a) se kuotat e shitura duhet të konsiderohen të pakualifikuara bazuar në legjislacionin e lartpërmendur.

b) gjatë dymbëdhjetë muajve që i paraprijnë aktit aktual dhe pas datës në të cilën investimet e mbajtura të kapitalit përfaqësonin një përqindje të të drejtave të votimit ose pjesëmarrjes që tejkalojnë pragun e kualifikimit, nuk kane kryer asnjë veprim shitje tjetër krejtësisht jo të kualifikuar të kuotave të kompanisë në fjalë.


c) rezervon të drejtën për të ushtruar mundësinë e shlyerjes së fitimeve kapitale në lidhje me aksionet e shitura deri më 30 qershor 2019 nën kushtet e parashikuara me Ligjin e 30 Dhjetorit 2018 n. 145 (publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 302, datë 31 dhjetor 2018, shtojca e zakonshme nr. 62 / L) art. 1 paragrafët 1053 dhe 1054 (2019 Ligji i Stabilitetit).

- 5.5 Pjesë e kësaj kontrate është ekstrakti i QKB dhe vendimi i Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë DB Wash International shpk, si dhe aktet e shoqërisë "Denim Inn" srl, pales blerëse, ku përfshihen akt themelimi, statuti, vendimi i asamblese ekstrakti i shoqërisë.
- 5.6 Çdo shtesë, ndryshim, zgjidhje ose heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga dhe në emër të secilës Palë.

5.7. Çdo mosmarrëveshje që lidhet me ekzekutimin, interpretimin dhe përfundimin e kësaj kontrate, përfshirë kompensimin për dëmet, do të transferohet dhe vendoset sipas barazisë nga një Bord Arbitrazhi, i përbërë nga tre arbitra, dy prej të cilëve caktohen me marrëveshje nga të dy Palët e kontrates dhe pala e tretë, me funksionet e presidentit do të zgjidhet me marrëveshje të përbashkët të dy arbitrave tashme të emëruar sipas këtij neni.

Në rast mosmarrëveshjeje, presidenti do të emërohet nga Presidenti i Gjykatës së Teramo (Itali).

Kontrata pasi u lexohet të lartpërmendurve prej meje noteres me ze të lartë dhe të qartë, dhe ata deklarojnë se janë dakort me përmbajtjen e saj, pasi ky është vullneti i tyre i lirë dhe i plotë, nënshkruhet prej tyre personalisht në prezencën time.



Unë Noterja Rovena Jakova vertetoj rregullisht këtë akt noterial në bazë të ligjit nr 110/2018 datë 20.12.2018 "Për noterinë".

PALA SHITËSE

CLAUDIO FORCHINI

*Claudio Forchini*

COSTANTINO FORCHINI

*Costantino Forchini*

*[Signature]*



PALA BLERËSE

SHOQERIA "DENIM INN" SRL

PERFAQESUAR NGA

STEFANO PIZZINGRILLI

*Stefano Pizzingrilli*  
*[Signature]*

NOTERE

ROVENA JAKOVA

*[Signature]*

Kjo kontrate iu lexua paleve edhe ne gjuhen italiane nga ana e perkthyeses ligjore ODETA XHAFA, banuese ne Durres, e njohur personalisht prej meje, me Nr. NUIS L82302504M.

Perkthyesë: ODETA XHAFA

*Odeta Xhafa*  
*[Signature]*